

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

nga prof. Sazan GURI

ETIMOLOGJIA DHE KUPTIMI I KONCEPTIT GRUA

Termi *Gea* në greqisht që në shqip d.t.th *tokë* e merr kuptimin primar nga fjala “*Gi*” (gji), që në gr. d.m.th. *tokë*. Por që në fakt, sipas A. Kolës, ky koncept rrjedh apo vjen nga “*Gji*”- *ri* i femrës.¹ Pas Kaosit, thotë Hesoidi, u krijua “*Gjea*”, (gjoksmadhja), për të ushqyer kështu si një mbështetëse e sigurt, ku do të vendosej gjithçka. Po me këtë fjalë lidhet ajo gjeologji, që shumëkush nga mësuesit e gjuhësisë apo gjeografisë apo gjeologjisë na mësojnë se e ka burimin në greqishte, kur të dyja njërrrokëshet e saj apo morfemat, si ajo “*gea*” dhe ajo *logos* shpjegohet, respektivisht, me fjalët shqipe, si “*gji*” dhe “*fjalë dije*”. Po me këtë kuptim lidhet edhe ajo si Gineka, gr. - Grua, shq., të cilat nuk ngjajnë me njëra-tjetrën, por po ta shohësh hollë-hollë kupton se koncepti “*gjineka*” (grua), është ngritur mbi atë fjalë që vetëm në shqip ka kuptim, siç është ajo njërrrokëshe “*gji*”. Sepse, jo vetëm që është tipar morfologjik i një gruaje, por edhe funksional i saj, me anë të së cilës mbahet dhe ushqehet fëmija, vlera e familjes, më saktë mbahet dhe riprodhohet ajo.² Me fjalën *gji* ka pasur dhe toponime të rëndësishme si *Gjigandia*. Sipas Hesiodit “kështu quhej Likia më parë dhe banorët e saj gjigandë nga e cila (Likia) kanë shpëtuar shumë mbishkrime dygjuhëshe, ligogreke, dhe në gjuhën e likeve. Gjuha e tyre u vërtetua nga Thomopulo 1912 si gjuhë pellazgo-shqipe.”³

Gruaja në mentalitetin historik shqiptar

Lëvizja feministe përgjat shekullit të kaluar dhe sot, me të drejt ankimoi dhimbjen që shoqëria e burrave iu kishte stisur ndër shekuj e mijëvjeçarë qenies femër, motër apo nënë. Dhe në këtë luftë e risi, sigurisht që u përfshi edhe pala shqiptare, ku shumë syresh, sidomos ato gra deri në ato me peshë fjale anatemonin tërë shoqërinë shqiptare, tanë burrat shqiptarë se historikisht kishin keq trajtuar gruan, nënën apo motrën shqiptare. Kanuni i Maleve, kanuni i Labërisë apo i Lekës, më tepër i përziente gjykimin se sa i ndihnte për arsyetimin, aq më tepër se shumica e tyre ndoshta kurrë nuk i kanë lecitur ato. Kjo përbën dhe ndryshimin e qendrimit ndaj femrës midis popullit shqiptar dhe popujve të tjerë. Nëse diku gjetkë, femra katandisej në mall apo në objekt i fyer, në shqipëri, arbani, albani, iliri, thraki deri në pellazgi, femra, siç do ta shikoni këtu e më poshtë, identifikohet

¹ Aristidh Kola, *Gjuha e Perendive*, v.1989

² Po me këtë fjalë lidhet dhe ka kuptim termi “*gjini*”, që do të thotë për gjithë atë brez fëmijësh, kafshësh, ose florë e faunë që rrjedhin nga një *gji* i caktuar. Po nga kjo fjalë rrjedh dhe vjen termi tjetër grek *gjitioni*, që sendërtohet përsëri nga dy fjalë të pastra shqipe, si gjithmonë njërrrokëshe, siç janë ato “*gji*” dhe “*tonë*” që do të thotë për atë lagje apo fshat apo fqinjë që kanë dalë prej një “*gji*”-ri, prej një paraardhësi të përbashkët. Kësisoj terma si “*gjitioni*”, “*gjineka*”, e shumë e shumë të tjera kalojnë dhe ruhen pa ndryshime thelbësore në fjalorin, po se po të vjetër grek, por edhe të sotëm.

³ Thomopulo, *Pellazgji*, v.1912

herë-herë në formën e një lloj protoplazmi për të mbushur boshllëqet e krijuara nga luftërat. Ndaj dhe personifikohej e lartësuar. *Pasuria e varreve femërore të zbuluara në Helopi – Lopësi (fusha e Dodonës) të shekujve X-VIII p.e.s, provon se pozita e gruas brenda për brenda familjes ishte ndër më të ngriturat*⁴.

Ju kujtojmë Penelopën nga Itaka, nënën e Udhëtarit (Odhisesë) apo gruan e të lartit (Laertit), që gjoja *lypte pe-në* ditën dhe e shturiste atë natë, me motivin që të mos prishte kurorën familiare. Dhe deri më ditët tona, ky rregull apo ligj mbriti te zakoni sa i vyer e fisnik, ku gratë për fatkeqësinë që iu ndodhta me burrat në luftë, nuk iu jepeshin tjetër njeriu. Në Epir, gruaja është pjesë përbërëse e bashkësisë familjare dhe trashëgimore, madje mund të ushtrojë përkohësisht të drejtat e të parit të familjes.⁵ Këto dekrete tregojnë qartë vendin e veçantë që zë gruaja në Epir, çka vlerësohet krejt ndryshe, po të krahasohet me praktikat juridike në Athinë, ku gruaja i nënshtrohet autoritetit të burrit. Në Epir, gruaja gëzon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e vet, për të cilën nuk paraqitet nevoja për praninë e ndonjë kujdestari. Në Athinë nuk mund të përfytyrohen dekrete të tilla. Epigrafitët e dinë mirë se, në formulën e dhënies së të drejtës së qytetarisë, në dekretet e zbuluara në Athinë, citohet etnika. T'u jepet grave *politeia* me dekret do të thotë të njihet kontributi i tyre i nevojshëm në të mirën e rendit shoqëror dhe t'u sigurohet mbrojtja e domosdoshme në rastet e fatkeqësive të kohës ose të mungesës së autoritetit të ndonjë kujdestarie. Për këtë mbrojtje, anëtarët e komunitetit bëhen garantë para perëndive.

Tërheqim vëmendjen mbi faktin kuptimplotë që në dallim nga helenët, ku gruaja ishte e ndrydhur, te pellazgët ajo gëzonte shumë të drejta dhe respektohej njësoj si burrat, duke arritur deri në postet më të larta...Ky respekt ndaj grave tregohej edhe me anë të Kremtimeve shumë popullore të Dionizit dodonas, mbrojtësit të gruas që vërtetojnë gjithashtu epërsinë e prestigjit, me të cilin i rrethonte tradita juridike gratë pellazge në mbarë pellazgjinë e lashtë. Por, tipar të spikatur, sikundër kanë gratë shqiptare sot, janë edhe Gratë e Paionisë, të cilat karakterizoheshin si shumë të mençura dhe gërthasin fort kur janë duke bërë fli. Ndodhin edhe këto: mbi kokë mbajnë një shtamë me ujë dhe qafën e mbajnë drejt në mënyrë që, kur janë duke ecur, shtama qëndron pa lëvizur dhe pa u lëkundur. Në të njëjtën kohë, fëmijëve u japin të pinë, duke i mbajtur të varur në gji, kalin e të shoqit e heqin për kapistre dhe e shpien për t'i dhënë ujë, kurse me duar thurin sende për të veshur.⁶

Për këto vetira është çuditur, i pari i persëve Dari, kur pa disa të rinj paionë që e nisën në këtë mënyrë motrën e tyre. (shek.V p.e.s.). A mund të më thoni ndonjë ndryshim, të dashur lexues me gratë e sotme të fshatit apo me një malësore. Tregojnë që një grua shtatzane e Malësisë së Madhe, duke dashur të shiste qymyr në shkodër, të cilën e mbante në kurriz, dhe në kokë një qyp me burrofresko (gjalp) dhe nëpër duar thurte, rrugës u detyrua të lindte dhe në fshat pas pazarit u kthye

⁴ Sipas nomeve, kanuneve, të shkruara e të pashkruara

⁵ Sipas Arsim Spahiut, te Shteti epirot, fq 94, v. 2011 që permend P. Cabanes, 1983, 2, p. 193-209.

⁶ Naim LACEJ, Tanagra - vazhdimësinë trojane me këto zona të sipërmendura e tregon syllambyllazi tipari i femrës shqiptare të këtyre anëve, ku femra është vetë aktiviteti. Ajo bën gjithë punët e familjes, vesh burrin dhe fëmijët, kujdeset për bagëtitë dhe të korrat. Ajo është zoja e shtëpisë, hyjnesha, shefja e vatrës.

në vend të qymyrit të shitur me një borokoc djalë në krah. A mund të ketë të ngjashëm si kjo grua shqiptare. Vetëm ato paone pellazge, të parat e shqiptarëve të sotëm. Kujtojmë se sa më mbrapa të kthehemi në histori, sidomos te shoqëria pellazgjike, aq më shumë shohim se gruaja luante një rol më të rëndësishëm, siç tregon edhe fakti se perënditë e Olimpës ishin 6 burra dhe 6 gra. Nga ana tjetër, duke qenë se “Mit-i” ka kuptimin e një mendimi të matur, Mit-i ishte edhe këshilltarja e urtë dhe bashkëshortja e Zeusit.⁷ Shih se në çfarë pozicioni vendosej gruaja qysh në momentet e para të historisë njerëzore.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar


Kështu është parë, të paktën, në të drejtën zakonore, nëse di ta lexosh atë me pak kujdes. Nëse doni një krahasim për këtë rast edhe mund ta themi. P.sh e drejta e vjetër Franceze deri në kohën e Napoleonit nuk i jepte po të njëjtën të drejtë femrës, kur ajo e gjente burrin në flagrancë, përkundrazi burri mund ta vriste gruan, nëse e kap në një gabim të tillë. Ndërsa, ‘E Drejta Zakonore, deri te ajo e Lek Dukagjinit e pajiste gruan me një fishek në pajë që kurrë nuk i binte ta përdorte i shoqi në rast se e gjente me jaranin. Sepse i shoqi duhet të luante më parë me tre skena ngjarjesh. Së pari, duhej të trokëlliste te porta e shtëpisë. Së dyti, mbasi e hapte me tërsëllimë këtë portë, duke ecur nëpër oborrin e shtëpisë duhej të godiste një kusi apo kovë si pa dashje me shqelm. Së treti, duhej të hapte derën e brendshme, duke u kollitur dhe pastaj derën e dhomës së gjumit dhe nëse akoma jarani nuk kishte ikur, i lindte e drejta që t’i vriste të dy me një plumb të fshehur nën jastëk, të ardhur nga paja, se ndryshe hynte në gjak me ata të jaranit. Praktikisht, pothuajse nuk ndodhte kurrë, çka bënte të ruante figurën e gruas si nënë, si amvisë apo si prodhimtare e familjes dhe/ose shoqërisë. Fantastike! Edhe kur i ndodhte që ajo (gruaja) mund të gabonte, ligja apo kanuni ishte stisur sikur e dënonte si frika në vresht, por asnjëherë nuk mund të ndodhte në praktikë.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 2, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Madje, në ligjet e kanuneve shpjegoheshin dhe ndaheshin rastet, kur femra, nëse ngjitej përpjetë rrugës tregonte se ishte marr me forcë, dhe ligja vepronte mbi dhunuesin dhe kur ajo zbriste tejposhtë rrugës, çka tregonte vullnetin e saj dënohej, veçse moralisht si “gjë turpe”. Pra, në asnjë rast, mbi të nuk vihej dorë. Këtë shenjë respekti ndaj saj e tregon edhe studiuesi albanolog gjerman George Hanns, kur në librin e vet “Në brigjet e Drinit” përshkruan raste sesi në një vend të trazuar si shqipëria otomane, vajzat, baresha të vetmuara baresin me dhën e dhi ndër lëndina e male të pa shqetësuar. Kësisoj, nderi i gruas, me të cilin personifikohej nderi i familjes nuk prekej. Në mbështetje të këtij citimi të vjen ndërment ngjarja e vërtetë e një

⁷ Arif MATEW, *Odiseja e Pabesueshme e një populli parahelen*, f. 298, v.2008



gruaje fisnike çame, e sjell nga Bajroni, të cilës Kajmekami i “kesh” ngarë vajzën. Kamejkam efendi! Të kam të lutur të më afrohesh një dakike se kam pak punë me ju - iu drejtua plaka. Ai ktheu kokën dhe u nis për tek gruaja e krishterë, që ishte shtatë-tetë metra larg tij. Sapo iu afrua, ajo i tha: *“Zotrote je i dërguar i Qeverisë në një vend, ku çdo njeri prej nesh e ka nderin gjënë më të shtrenjtë dhe kush ia prek atë, e paguan me kokën e tij”*.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 3, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Edhe në botën etruske, gratë e këtij populli tipizoheshin si gra të shkolluara, që shkonin në teatër dhe mernin pjesë në jetën publike, ku mund të pinin dhe të kërcenin. Këtë e tegon një qeramikë e punuar dhe e gjetur në trevat shqiptare, ku vërehet një pikturë e skalitur për të shprehur valë që nga studius interpretohet si valë pirrike e grave, siç i dokumenton kjo qeramikë e pikturuar. Nga ana tjetër, kjo dëshmon po ashtu shkallën shoqërore të privilegjuar të grave në trevat, ku vepronte e drejta zakonore pellazge. Po ashtu, sipas studiusëve të tjerë gjen interpretime edhe për Gratë e Ilirisë, të cilat ishin të pranishme në bankete dhe në mbrëmje, ku shpesh pihej verë.

Komenti - 4, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Ndërkohë, që një studius tjetër, si ai M.Ritton pohon se: *‘Gratë arvanitase janë më të pastra se gratë greke’*⁸; Por, le të marim festën paganë të Dhemetrës pellazge, të rrënjësuar prej mijëra vjetësh rreth e qark Apolonisë, që e kremtonin deri dje mbarë myzeqarët, çdo shtator, duke u larë bashkarisht në det. Për respektin ndaj grave shqiptare shprehet edhe studiusi gjerman G.Hahn, ku në librin e vet që përshkruan udhëtimin e tij më 1854 nëpër brigjet tatëpjetë të lumit Drin, mbasi sheh një femër 15-16 vjeç që bariste e vetme⁹, duke kullotur dhi e dhën në male thot se: *Si ka mundësi në këtë vend të trazuar e të pasigurtë e me probleme me perandorinë osmane, të shëtisë një vajzë e vetme kaq e sigurtë*. Pra, kush e mbronte atë vajzë? Ndoshta i madhi gjuhëtar apo historian dhe i apasionuari i shqiptarëve, e dinte, por nuk e thoshte, por ndoshta nuk e dinte kodin e ardhur nga lashtësia, nga gratë etruske, ilire, paone, arvanitase, etj., se grua, jo nuk prekej, por si forcë prodhuese respektohej deri në legjendë.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 5, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Femra shqiptare mund të udhëtojë e vetme kudo, pa u rrezikuar të pësojë as më të voglin poshtërim. Njeriu, që ajo e merr nën mbrojtjen e saj, gëzon të njëjtat privilegje. Ai mund të përshkojë pa frikë fisin armik. Askush nuk do të guxonte ta prekte atë. Sepse, aq të respektuara kanë qenë gratë në trevat pellazgjike, saqë sipas një dokumentimi në Foinikë (Finiqi i sotëm), plot 500 gra, - për dikë tjetër 9000 (na duket pak e ekzagjeruar) – thirreshin me emrin Marë - për m(b)arësi. Sipas studiusit

⁸ M.Ritton

⁹ George von Hahn, *Studime shqiptare, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, v. 2007.*

M. Huacunthe Hecquard mësojmë se: *“Në asnjë vend të botës, femrat nuk janë më të respektuara dhe nuk ushtrojnë një veprimtari më të fuqishme se shqiptarët, dhe se disa nëna shqiptare kanë përzënë prej shtëpisë bijtë e vet, pasi ata ishin larguar nga fronti i luftës, ato i kishin kthyer në fushën e betejës”¹⁰*;

Komenti - 6, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Në Shqipëri janë gratë ato që punojnë. Ato janë fisnike; nuk e njohin prostitucionin dhe një fëmijë i paligjshëm është thënë të jetë një humbje nderi si për nënën që e lind, ashtu edhe për familjen dhe për bashkësinë ku jeton ajo. ...shqiptari është i ndershëm, në mënyrë të veçantë, në qëndrimin ndaj grave. Thuhet se para luftës, një grua e vetme dhe e pambrojtur mund të udhëtonte e sigurtë nga njëri cep i Shqipërisë në tjetrin. Por, edhe letërsia gojore shqiptare që përbëhet nga ritet e stinëve, ritet familjare, gjëzat, proverbat, përrallat, legjendat, këngët lirike dhe shoqërore, balladat dhe poemat dhe më në fund nga ciklet e kreshnikëve flet edhe për institucionin grua. Vendi, ku lëvrohej dhe transmetohej kjo letërsi e pasur e pashkruar ishte kryesisht vatra familjare, ku nipërit mësonin nga gjyshërit thesarin e letërsisë popullore. Në përgjithësi, këto krijime letrare, rallë ishin gërshtuar me tematikë fetare. Më interesante është ballada e Gjergj Elez Alisë. Ai edhe pse ishte i sëmurë rëndë, me shumë plagë në trup, ngrihet nga shtrati dhe hyn në dyluftim me bajlozin, një arap i zi, i cili kërkon si haraç përveç të tjerave edhe motrën e tij. Fabula është shumë tërheqëse, e ndërtuar në një mjedis epik, ku ka si motiv qendror mbrojtjen deri në vdekje të nderit të familjes.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 7, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Jo më kot, piktori nga Vojvodina B.Vranisheviq theksonte për luftëtarët shqiptarë, por më tepër për gruan shqiptare se: *Është mrekulli ta shohësh popullin trim luftëtar shqiptar... Ata nuk lodhen për pasuri e luks... gjithmonë janë të armatosur, madje edhe gratë të cilat njihen nga shikimi i tyre krenar dhe të ecurit të sigurtë... Lumturinë nuk e kërkojnë te bukuria, por në kënaqësinë e tyre, të burrit të vet, të fëmijëve dhe popullit të tyre”¹¹*; Ndaj, Lord Bajroni citonte me plot finesë dhe respekt për gruan shqiptare se: *Femra shqiptare vetëm njërit i’a fal trupin dhe zemrën*¹²; Tek ne, ende, gjallon shprehja (në realitet kategoria) zot i shtëpisë, krahas asaj, zotë shtëpie. Vetëm kaq mjafton që të dimë se ata ndanin pozita të barabarta në familje.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 8, Gruaja në të drejtën e vjetër zakonore – shresa më e respektuar

Në sajë të gruas, shqiptari ka formuar kultin e familjes aq sa solidariteti mes anëtarëve të familjes është shumë i fortë. Me kultin e familjes, dhe si pasojë e kësaj ndjenje, shqiptari ka gjithashtu edhe

¹⁰ M. Huacunthe HECQUARD, *Histoire et description de la Haute-Albanie ou Guégarie*, 1863.

¹¹ B.VRANISHEVIQ, *Piktor nga Vojvodina, Libri & Komenti online*

¹² Lord BAJRONI, *Travels in Albania in 1809-1810, Udhëtime në Shqipëri më 1809-1810*

kultin e shtëpisë, të vatrës, ose “home” siç i thotë anglezi. Pasi bën ca para nuk ka gjë më të ngutshme për të se sa të shkojë në vendin e vet e të ndërtojë një shtëpi të re, më të mirë, më të bukur se të vjetrën.¹³ Dhe shtëpizën e re shqiptari e ka për të treguar burrërinë para fisit, para familjes, por mbi të gjitha para gruas, para vatrës së familjes, si për t’i thënë se jam ‘u’ - burri i shtëpisë.

GRUAJA – KODI I NDERIT TË FAMILJES SHQIPARE

Komenti - 9, Gruaja dhe borxhi i burrave shqiptare sot ndaj Saj

Fakte: Dihet nga të gjithë që në migrimin e parë të shqiptarëve në vitet ‘90, ata u pritën mjaft mirë nga italianët, por si emigrant dhe si të paparë që ishin, edhe bënë ca gjera. Kështu që në emigrimin e vitit 1992, që u pritën si mos më keq në stadiumin e Barit, kishin marrë nofkën si njerëz bastard, gjë e cila i shoqëroi deri në vitet 97, 98, mbasi një prift Torinez botoi një libër me shembuj sesi familjet italiane të formuara me gra shqiptare gëzonin shëndet të plotë familjar krahasuar me ato familje italiane italiane. Madje, vete burrat italianë nuk linin rast pa thënë se nuk kanë të krahasuar familjet italiane të ndërtuara me bazë me femrat shqiptare. Dhe ç’vertetoi pastori? Që këta shqiptarë emigrant të damkosur me nofkën si barbare e bastard nuk ka mundësi të jenë të tillë, sepse këto femra shqiptare, këto motra shqiptare, këto gra shqiptare, janë ato nëna shqiptare që kanë lindur këta djem që ne gabimisht duhet t’i kemi quajtur bastard e barbarë. Pra, nderi dhe vendi i emigrantëve shqiptarë iu dha pikërisht nga motrat, vajzat dhe nënat shqiptare. Ky është borxhi që burrat shqiptarë iu kanë grave dhe nënave shqiptare.

“RRËNJËT TONA”

¹³ Njëzet e tre shtëpi të reja e të rehatshme, më të këndshme se të tjerat, të cilat u takonin njëzet e tre të rinjve që kishin punuar disa vjet në SHBA.